

TOPONIMIA E DEVOLLIT-BASHKUDHËTARË I ORIGJINËS, HISTORISË DHE GJUHËS SHQIPE

Hysen **KOCILLARI**¹

PËRMBLEDHJE

Religjioni i Devollit, si njësi administrative më vehte, nahije, nënprefekturë, rreth dhe sot bashki, shtrihet në gjeohapsirën lindore e perëndimore të lumit me të njëjtin emër, fushë gropën e Devollit, në pjesën më juglindore të Shqipërisë. Territori që ze shtrihet në gjatësinë gjeografike 210 40, në skajin më lindor të Shqipërisë, në fshatin Vërnik. Në veri, veriperëndim e në perëndim kufizohet me Bashkinë e Korçës, lartësitë që zbresin në liqenin e Prespës e gjatë kurrizit të Moravës. Në perëndim me Bashkinë e Korçës e lidh Gryka e Cangonjit. Në jugperëndim kufizohet me Bashkinë e Kolonjës nga pjerrësitë verilindore të malit të Gramozit dhe në juglindje, lindje e verilindje kufizohet me Republikën e Greqisë, me një vijë kufitare prej 83 km, përgjatë lartësive mbi Nikolicë, Arrëzë, Qytezë, Vidohovë, Kapshticë, Vërnik, Rakickë e deri në lartësinë e Llapishtit. Në lindjendodhet Gryka e Kapshticës që e lidh me Greqinë. Devolli shtrihet në një territor prej 429 km², përfshin 45 fshatra e qytetin e Bilisht me 42567 banorë, viti 2015. Në këtë trajtesë modeste synojmë të ndriçojmë pasurinë e toponimisë në njësinë etnografike krahinore të Devollit duke e mbështetur fort përmbajtjen e tyre në disa faktorë që kanë ndikuar në formimin e tyre. Metodologjia jonë e punës synon të parashtrojmë të dhëna që lidhen me përmbajtje mitesh e legjendash për origjinën prehistorike të banorëve Dasaretas e Eorodë; Të dhëna për territoret ku shtriheshin në antikitet etnitë paraardhëse të devollinjëve të sotëm; Zhvillime kryesore historike që kanë ndodhur në territoret Dasaretisë e të Eordesë dhe Hulumtimin e toponimeve të fshatrave të Devollit. Analizat e përfundimet për temën që po trajtojmë, i referohen, përgjithësisht, toponimisë së njësisë etnografike të krahinës së Devollit por në mënyrë specifike asaj që kemi mbledhur në fshatra të Devollit.

Fjalë kyçe – Devolli, mit, legjendat, toponimia, origjina, historia.

HYRJE

Termi “mit” është i lashtë dhe kuptimi semantik vjen nga greqishtja e vjetër “Mithos” që do të thotë fjalë, bisedë a rrëfim, gojëdhënë, fabul, ligjërime. Mitet e legjendat në përmbajtje janë tregime të vockla, rrefenjeza, si të thuash pjesëza, copëza jete të historisë së lashtë, dukurive njerëzore e jonjerëzore të ndërtuara mbi bazë të imagjinatës, përfytyrimeve e konceptimeve të mbinatyrshme.

1. TOPONIMIA E DEVOLLIT-BASHKUDHËTARË I ORIGJINËS, HISORISË DHE GJUHËS SHQIPE

1.1 MITOLOGJIA PER ORIGJINEN E DASARETEVE E TE EORDEJVE

Termi “mit” është i lashtë dhe kuptimi semantik vjen nga greqishtja e vjetër “Mithos” që do të thotë fjalë, bisedë a rrëfim, gojëdhënë, fabul, ligjërime. Mitet e legjendat në përmbajtje janë tregime të vockla, rrefenjeza, si të thuash pjesëza, copëza jete të historisë së lashtë, dukurive njerëzore e jonjerëzore të ndërtuara mbi bazë të imagjinatës, përfytyrimeve e konceptimeve të mbinatyrshme. Për lindjen e mitologjisë akademiku A. Uçi pohon: “Koha e formimit të rrëfimeve të para mitologjike, siç është vërtetuar nga shkenca, i përket periudhës së Paleolitit. Intervali nga ky cak kohor deri në shthurjen e komunitetit primitiv dhe afrimin e shoqërisë me diferencime sociale ka

¹ *Studiues, historian*

qënë periudha më frytdhënëse e krijimit të mitologjisë, kur ajo bënte një jetë aktive, dhe mbizotëronte në jetën shpirtërore të fiseve primitive.”² Mitologjia është shkenca që studion shfaqje të ndërlikuara të jetës shpirtërore të shoqërisë e cila “ka ushtruar për mijëra vjet me radhë e vazhdon të ushtrojë ndikim të madh në kulturën e njerëzimit. ”Zhvillimet të shoqërisë çuan në krijimin e identitetit të popujve i cili dihet që “as jepet, as merret, as tjetësohejt” sepse secili më parë kishte përfunduar forimin e identitetit të tij. Në mitologjinë shqiptare janë ruajtur tregime, mite e legjenda që përmbajtja e tyre lidhet me origjinën e territoret ku shtriheshin ilirët e etnitë e fiseve Dasaretë dhe Eordë, paraardhësit e devollinjëve të sotëm.

*Apollodori shkruan: “Më vonë, (Kadmi-H.K.) së bashku me Harmoninë, shkoi e u vendos tek fisi i Enkelejve, fis ilir, pranë liqenit të Ohrit. Çifti këtu jetoi e lindi shumë fëmijë, ndër ta është Iliriosi, paraardhësi i Ilirëve.”*³

Apiani thotë: “Bijtë e Ilirit kanë qënë Enhelau, Autari, Dardani, Medi, Taulanti e Perrebi; vajzat e tij ishin Parta, Daorta, Dasara e të tjera, nga kanë rrjedhur taulantët, perrebejtë, enhelejt, autariatët, dardanët, parthinët, dasaretët e darsejtë. Thonë se Autari pati për bir Panonin ose Paionin, dhe ky i fundit pati për bij Skordiskun e Tribalin, nga të cilët morën emrin edhe fiset.”⁴ *Herodoti* përcjell një legjende për zonën ku shtrihet Eordea, kur pohon: “Perdika, i biri i shtatë i këtij Aleksandri, është ai që ndërtoi në këtë mënyrë shtetin e maqedonëve. Prej Argo shkuan tek ilirët tre vëllezër pinjollë të Temenit: Gauani, Aeropi, dhe Perdika; dhe duke ikur nga ilirët u vendosën në Maqedoninë e Sipërme në qytetin Lebae. Këtu ata shërbenin me rrogë tek mbreti, njëri duke kullotur kuajtë, tjetri gjedhët, kurse i vogli prej tyre, Perdika, qingjat.”⁵ Për toponimin Lebaia dimë që ishte kryeqendra e mbretit Perdika I që themeloi Maqedoninë në vitet 700 p.e.s., dhe se më vonë mbeti emër i një vendbanimi të kthyer në fshat të thjeshtë. Studiuesit që e citojnë emrin Eleova shkruajnë që ky fshat deri në vitin 1878 ishte pjesë e Kazasë së Kosturit dhe më pas i kaloi asaj të Follorinës.

Prej studimit të L. Jankovski dhe A. Bakratcheff të cilët renditin emrat e 804 fshatrave e qyteteve në Greqinë e Veriut që administrate shtetërore greke gjatë viteve 1926-1928 ia ndërroi emrat tradicionalo-historik me emra të rinj grek, mësojmë që historikisht ishte pjesë e Kazasë së Kosturit me emrin Lakia dhe pastaj përfundoi në Levaia. Duke ditur që pasuria e trashëguar e miteve dhe e legjendave është një mundësi që ndihmon popujt e botës për të imagjinuar, fantazuar apo përfytyruar historinë e tyre, “historianët, duke i ndërthur rrëfenjat e ndryshme, mitologjike kanë formuar historicizmin e mitit”⁶ Dhe për ta çuar mendimin më tej, sipas Tukididit, “miti u ekspozohet të njëjtave kritika si fakti historik.”⁷ Historianët e studiuesit në punën për të nxjerrë përfundime që lidhen me prehistorinë, origjinën e territoret që zinin komunitete të caktuar, lipset të marrin në konsideratë dhe përmbajtjen e mitologjisë së krijuar prej tyre.

1.2 HISTORIA E SHKRUAR PËR DASARETINË DHE EORDENE

Ilirët janë ndër popujt më të vjetër dhe gjuha e tyre, ilirishtja, bën pjesë “në familjen e gjuhëve indoevropjave, në atë familje gjuhësh me burim të përbashkët, të cilat qysh nga kohërat e hershme prehistorike, janë folur në trevat që nga India deri në Evropë”⁸ Homeri, shek. VIII p.e.s., “Iliada” e “Odisea” “përmend fiset ilirë të Paonëve e Thesprotëve. Alkmani, VII p.e.s. ka shkruar vargje për ilirët. Hekateu, shek. VI p.e.s. “është logografi i parë që citon enkelejtë e dasaretët.”⁹ Njësia

² Alfred Uçi “Mitologjia-Folklori-Letërsia”, Tiranë, 1982, fq.15

³ Ilirët dhe Iliria te autorët anticë, Tiranë, 2002, fq. 74

⁴ Po aty, fq.250.

⁵ Po aty, fq.21.

⁶ Arsim Spahiu “Pellazgët dhe ilirët në Greqinë e vjetër”, Tiranë, 2006, fq. 19.

⁷ Po aty, fq. 20.

⁸ Shaban Demiraj “Gjuha shqipe dhe historia e saj”, Tiranë, 1988, fq. 19.

⁹ Aleksandër Stipčević “ILIRET-historia, jeta, kultura, simbolet e kultit”, Tiranë, 2002, fq. 22.

etnografike e krahinës së Devollit shtrihet në territore që në lashtësi banoreshin nga etn4i fisesh ilire, gjysma nga Dasaretët, pjesa perëndimore e saj, sot Devolli, dhe gjysma tjetër nga Eordët, pjesa lindore, sot në Greqi. Kështu, rrënjët e popullsisë së sotme të krahinës së Devollit janë pjesërisht në territoret e Dasaretisë e pjesërisht të Eordesë.

Herodoti “Historitë”, shek. V p.e.s. “... është i pari që për të treguar thellësinë e tokave ilire përdori togfjalëshin “tokave ilire (Libri IV, 48)”.¹⁰ Gjithashtu, Ai citon termin “ilirët” kur shkruan: “Prej Argo shkuan tek ilirët tre vëllezër pinjollë të Temenit: Gauani, Aeropi dhe Perdika.”¹¹ Në vijim të veprës ndeshim dhe “Dy rastet e tjera kur Herodoti përmend ilirët kanë të bëjnë, gjithashtu, me kufijtë lindorë të tyre, ku ata takohen me maqedonët (Libri VIII, 137; IX, 23).”¹² Gjithashtu, është po Herodoti “babai i historisë”, i pari që përmend emrin “EORDE”. Tek “Anketa” shkruan: “PELLAZGËT, popull parahelen midis të cilëve Lelegët ... MAQEDONI: Eordët, Beotianët, Pelagonët, Pierët. THESALI: Enianët, Perrhebët, Lapitët, Magnetët, Pagasianët...”¹³ Historiani, gjatë përshkrimit të luftës së helenëve kundër persëve të udhëhequr nga Kserksi, pohonon: “Helenët e Thrakisë dhe të ishujve pranë saj kishin njëqind e njëzet anije; në këto anije kishte njëzet e katër mijë burra; në këmbësori kishte thrakë, paionë, eordë, botiaj etj.”¹⁴

Tuididi, shek. V p.e.s., shkruan: “Maqedoni: fiset Eordë (theksimi-H.K.), Botianë, Pierë.”¹⁵

E. Jacques thotë: “Pirro, biri i Akilit legjendar, është i pari person gjysëm legjendar e gjysëm historik që e kapërceu kufirin e legjendës së mjegullt dhe i mbledhi sëbashku fiset e shpërndara pellzge. Menjëherë pas rënies së Trojës që, sipas traditës, datohet rreth vitit 1284 p.e.s., Pirro



Neptolemi, djali i Akili, erdhi në pjesën jugperëndimore të gadishullit dhe i bashkoi luftëtarët pellazgë të asaj treve nën udhëheqjen e tij. Kjo është treva që sot njihet nga shqiptarët Toskëri. Këto fise përfshinin tesprotët e Sarandës e të Camërisë që shtriheshin në jug deri në gjirin e Artës, kaonët e Kurveleshit e të Himarës apo të Labërisë, atintanët e Përmetit e të Tepelenës, si dhe dasaretët e Beratit dhe të trevave të sotme të Ohrit e të Korçës.”¹⁶

Ptolemeu shkruan: “Në tokën e Eordejve (eordaioi): - Skampis 45 gradë 45 minuta 40 gradë 20 minuta; - Dibolos 45 gradë 45 minuta 40 gradë 10 minuta; - Daulia 45 gradë 30 minuta 40 gradë.”¹⁷

Shekulli II p.e.s. është koha kur shkëputet hallka e përdorimit të shumë emrave me origjinë parahistorike. Kjo është koha kur Eordea u dogj e u shkretua, pati

fatin dhe e pësoi ashtu si mbi 70 qytete të Ilirisë nga ushtria e konsullit famëkeq romak, Sulpicit e gjeneralëve mizorë si Pal Emili me shokë. Kjo hipotezë mund të jetë e besueshme sepse kjo është koha kur prej këtyre territoreve u morën mbi 150 mijë robër, kur popullsia u grabit e gjithë pasuria e tundshme dhe e patundëshme dhe momenti kur u dogjën e sheshuan mbi 70 qytete të Ilirisë. Më pas nisën të përdoren format:

¹⁰Neritan Ceka “ILIRET”, Tiranë, 2001, fq. 27.

¹¹Vepër e cituar Ilirët..., fq. 20.

¹²N. Ceka, vepër e cituar, fq. 27

¹³Mathieu Aref “Mikenët-Pellazgët, Greqia ose zgjidhja e një enigme”, Plejad, 2008, fq. 12.

¹⁴Poaty, fq 69-70.

¹⁵Po aty, fq. 80.

¹⁶Edwin Jacques “Shqiptarët”, Tiranë, 1995, fq. 92-93.

¹⁷Ilirët..., vepër e cituar, fq. 268.

Deabolis=Debolis=Diabol=Deboli=Dievalo=Devali=Devoli=Devolli, që vazhduan gjatë Mesjetës së Hershme, e të Vonë, 800-1500.

1.3 GJETJE ARKEOLOGJIKE PREHISTORIKE NË DEVOLL

Studiuesit pohojnë që në Devoll dëshmojnë vendbanime prej Neolitit, 6500-2500 p.e.s. Në Iliri gjatë shek. V-VI p.e.s. ndodhi dukuria që quhet "Periudha e qyteteve ilire". Mënyrat e ndërtimit të fotifikimeve realizoheshin mbi dy lloje teknikash: a) Fortifikime të ndërtuar me ledhe, përzierje gurësh të thyer e coptuar në masa të vogla përzier me zhavor. b) Fotifikime të ndërtuar me mur guri. Stacionet arkeologjike në religjionin e Devollit gjatë gjysmës së dytë të shekullit që kaloi, u bënë objekt i një pune të madhe si në intensifikimin e gërmimeve, ashtu dhe në studimin e materialeve të grumbulluara e botimet kushtuar vlerave shkencore që mbartnin. Arkeologët M. Korkuti, Zh. Andrea, N. Ceka, Gj. Karaiskaj, N. Bodinaku, S. Aliu, L. Bejko etj. janë disa emra të njohur që kryen gërmime arkeologjike në territorin ku shtrihet Dasaretia. Në territorin e Dasaretisë, zonës që ze Devolli i sotëm, janë ndërtuar kala, mure fortifikimi e gradina si Shpella e Trenit në Grykën e Ujkut buzë Prespës së Vogël, pikturat prehistorike tek Shkëmbi Nuses, dumat ilire të Gradishtës së Shyecit, kalaja e Trajanit, kalaja e Gradishtës, kalaja e Vendtrokut, muri i Mokut, kalaja e Bilishtit (Kokëgllava), vendbanimet ku janë zbuluar gjetje arkeologjike me vlerë si themele ndërtimesh, tuba e qyngje, sende metalike e qeramike, qypa të mëdhenj (pitose), stoli zbukurimi etj. si në Polihor, Nikolicë, Shkallëzë, në të djathtë të rrugës Miras Arrëz, Shënmilli (Shën Mëhilli), pranë Cetës, Ziçishtit, Kapandriq, pranë Pilurit, ndoshta Pelioni ku u ndeshën ilirët me në krye Klitin me ushtrinë e Aleksandrit të Madh, 335 p.e.s. Bojazet e Ulicat, Vishocicë, Pavliq, Progër etj.

1.4 SHPELLA E UJKUT OSE SHPELLA E TRENIT

Shpella e Trenit është vendbanim prehistorik që ndodhet pranë Grykës së Ujkut, në fund të një kodre shkëmbore, rreth 15 m pranë bregut të liqenit të Prespës së Vogël. Arkeologët pohojnë që origjina e saj është epokës së Neolitit, shek. 6500-2500 p.e.s. Zona neolitike të zbuluar në Shqipëri janë: "Neoliti-H. K.) i lashtë=Kolsh I, Bllacë II, Cetushi, Burim, Podgorie, Vashtëmi, Barç I, Vlushë II, Tren I."¹⁸

Akademiku N. Ceka, për kështjellat rreth liqenit të Prespës, shkruan: "Cila është kështjella më e lashtë e vendit tonë? Unë do t'ju çoja në liqenin e Prespës së Vogël, pranë fshatit Tren, atje ku ai ngushtohet në mes dy maleve dhe ngjan më tepër si një lumë i thellë. Në fundin e gjuhës së liqenit ngrihet faqja e thiktë e një shkëmbi e nxin gryka e një shpelle, e cila quhet Shpella e Ujkut..."¹⁹ M. Kërkuti dhe Zh. Andrea eksploruan për një kohë materialin gjeologjik në Shpellën e Trenit, dhe aty gjetën vegla pune të gdhendura në kockë, gur, strall, bri, llojshmëri të pasur qeramike etj. Akademiku deklaroi: "Vendbanimi I Maliqit, fazat Maliq III abcd dhe ai Trenit, në fazat Tren ab, na kanë dhënë si në statigrafinë vertikale dhe në atë horizontale, një lëndë sa të pasur aq dhe të qartë arkeologjike që dëshmon për zhvillimin gradual e të pandërprerë të kulturës



gjatë periudhës së bronzit të hershëm (Maliq III ab e Tren I-a), gjatë periudhës së bronzit të mesëm (Maliq III-c) e gjatë periudhës së bronzit të vonë (Maliq-III d e Tren IIb)."²⁰ Studiuesit pasurinë materiale prej qeramike me të gjithë llojshmërinë e saj në ngjyra e forma, e vlerësojnë si vlerë arkeologjike që provon origjinën prehistorike të Devollit. Qeramika e pikturuar devollite, thekson akademiku M. Korkuti, është ajo që i jep vulën tërë poqerisë së bronzit të vonë dhe "vazhdoi ta luante këtë rol përcaktues edhe gjatë periudhës

¹⁸Mathieu Aref "Shqipëria-odiseja e pabesueshme e një populli parahelen", Plejad, fq. 97.

¹⁹Neritan Ceka "Udhëtim nëpër kështjellat ilira", fq. 9-10.

²⁰Kuvendi i studimeve ilire, Tiranë, fq. 76.

së parë të hekurit në territorin e Ilirisë juglindore.”²¹ Zh. Andrea shkruan se janë një varg studiuesish të njohur të huaj, si H.A. Heuerley, S.I. Dakaris, prof. Grashanin, prof. N.G.L. Hammond, Zh. Jacques, etj. si dhe shqiptarë F. Prendi, M. Korkuti, Zh. Andrea, N. Ceka, etj. të cilët janë shprehur për “qeramikën devollite.” Në vijim ajo thotë: “Gjithashtu është shprehur mendimi se krijues dhe bartës të qeramikës së pikturuar në krahinat tona ka qënë ajo popullsi që në burimet e shkruara përmendet me emrin Dasaretët. Për këtë arsye dhe për faktin që ne mund të ndjekim një vazhdimësi të pandërprerë të prodhimit të saj, në këtë krahinë, duke filuar nga periudha e fundit të epokës bronzit deri në shek. VI p.e.s., jemi të prirur që ta quajmë qeramikën tone të pikturuar “Qeramikë Devollite...”²² E. Jacques, amerikan, thotë: “Një shpellë natyrore me gjurmë vendbanimi, gjatë viteve të Neolitit të vonë u gjet në Tren, pranë liqenit të Prespës së Vogël...”²³, ndërsa për “Qeramikën Devollite”, shkruan: “Kjo qeramikë e “Devollit” do të përhapej me shpejtësi kudo, duke u shndërruar në tipar dallues i kulturës së Kohës Bakrit.”²⁴ Edhe studiuesi B. Coviç pranon që “Qeramika devollite” kur për të deklarn se ajo “është ilire për arsyen e thjeshtë se qendra e parë e formimit dhe e zhvillimit të parë të saj shekullor ndodhet në krahinën e Devollit, e cila është ilire.”²⁵

1.5 KALAJA E TRAJANIT

Kalaja e Trajanit ndodhet në kreshtë shkëmbore të malit të Trajanit, 1245 m, në verilindje të fshatit Tren të Devollit mban emrin e Trajanit, perandorit të Romës, 98-117 i cili ishte me origjinë ilire. Historianët dhe arkeologët pohojnë: “Kalaja e Trajanit është territori prehistorik më i madh i fortifikuar në pellgun e dasaretëve i njohur deri tani në territorin e Ilirisë.

Gj. Karissskaj thotë: “Ai përfshin brenda mureve, që kanë gjatësi të përgjithshme prej 3 km., një sipërfaqe prej 32 ha.”²⁶ dhe në vijim përshkruan: “Kuptohet, brenda zonës së fortifikuar gjallonte jeta një komuniteti banorësh që kryenin punë bujqësore, blektorale, zejtarie, peshkimi etj. Kalaja është ndërtuar sipër një kodre të lartë rreth 1200 m. mbi nivelin e detit. Muri rrethues është i gjatë afro 500 m. e është ndërtuar, si dhe fortifikimet fqinjë, me blloqe gurësh të papunuar me gjatësi deri rreth 2.30 m, gjerësi 1.60-2.10 m, që janë vendosur sipër njëri tjetrit pa mjet lidhës” Për kohën e ndërtimit shprehet: “Në kalanë e Trajanit nuk janë kryer punime arkeologjike, objekte të gjetura në afërsi, që me sa duket i përkasin një tume, datohen në shek. VIII-VII p.e.s.”²⁷ Autorë të njohur të kohës, Tit Livi, Kurt Ruffi, Ariani etj, e citojnë si një nga qendrat më të rëndësishme protourbane të Ilirisë.

1.6 KALAJA E VENTROKUT

Kalaja e Ventrokut ndodhet pranë vendbanimit shpellor të Trenit e Kalasë së Trajanit dhe gjendet majë një kodre të vogël shkëmbore 50 m të lartë e ze një sipërfaqe të vogël prej 0.6 ha. Muri rrethues është 280 m. i gjatë e në pjesën lindore është i lidhur me shkëmbinj natyrorë prandaj këtu realizuesit e tij nuk ndërtuan mur. Për të hyrë në kala ka vetëm një hyrje e cila ndodhet në anën e fushës, ndërsa në anën veriore të kalasë si dhe në mesin e saj ruhen dy poirgje të krijuar artificialisht me gurë të vegjël të cilat quhen “tumula kufizuese”. Banorët prehistorik i kishin ndërtuar ato me qellim që të mbronin kalanë në pikat e



²¹E. Jacques, *vepër e cituar*, fq. 10.

²²Kuvendi..., *vepër e cituar*, fq. 172-173.

²³E. Jacques, *vepër e cituar*, fq. 8.

²⁴Po aty, fq. 9.

²⁵A. Spahiu “Pellazgët...”, *vepër e cituar*, fq. 277.

²⁶Gjergj Karaiskaj “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, Tiranë, 1981

²⁷Po aty, fq. 23.

saj më delikate si dhe duke patur parasysh vendin dominues ku ishin ndërtuar, i shfrytëzonin si pika vrojtimi.

Mbështetur në materialet arkeologjike ajo datohet si e periudhës së bronzit të vonë. Gjithashtu aty janë gjetur fragmente qeramike të periudhës së parë e të dytë të hekurit. Territori brenda kalasë së Ventrokut ishte vendbanim, aty banonte një bashkësi e vogël njërëzish të cilët merreshin, kryeshisht, me blegtori e me peshkim. Në një fragment përshkrimi të studiuesit Gj. Karaiskaj lexojmë: "Muret e saj (Kalasë së Ventrokut-H.K.) duken nga larg si një rreth i hedhur në shkëmb. Edhe këtu banorët e lashtë të kësaj zone kishin krijuar një fortifikim, ku mund të



mbroheshin dhe njëkohësisht të pengonin futjen e armikut në grykat e liqenit. Vetëm se kishin përdorur një mënyrë tjetër ndërtimi: në vend të gurëve të mëdhenj ata kishin ngritur një ledh me argjilë e me gurë të vegjël, mbi të cilët duket se ka pasur një gardh prej trarësh."²⁸ Qëllimi i ndërtimit të murit fortifikues ishte me karakter strategjik mbrojtës.

1.7 GRADISHTA E SHYECIT


Gradishta e Shyecit është ndërtuar mbi një kodër të vogël shkëmbore e shpatet e saj zbresin në deri në ujërat e liqenit të Prespës së Vogël. Banorët vendas e njohin me emrin "Gradishta e Shyecit". Është ndërtim fortifikues që datohet i periudhës së Neolitit të Vonë dhe hyn në grupin e fortifikimeve me ledhe i cili ishte i përdorur në Ilirinë e Veriut. Gradishta e Shyecit është e vetmja e e tillë që është ruajtur në jugun e saj. Fortifikimi ngrihet mbi një kodër me lartësi të vogël dhe përfshin një sipërfaqe prej 1.5 ha. Pjesa e ulët e tij që ndodhet në anën e liqenit nuk është e fortifikuar sepse mbrohet në mënyrë natyrale nga liqeni, ndërsa anët e tjera janë fortifikuar me ledhe të përbërë nga përzjerja e dheut, zhavorrit dhe gurëve me përmasa të vogla. Brenda zonës së fortifikimit nuk janë gjetur sende qeramike e gjurmë banesash tregues që thotë se zona brenda tij përdorej vetëm në raste rreziku nga popullsia që banonte pranë tij.

Vendbanimet të mbrojtur me ledhe rrethuese të ndërtuar me gurë të thyer të përzier me dhë, quheshin "gradina". Ndonëse emërtimi është me origjinë prehistorike, kjo fjalë është aktive në fjalorin e përditshëm të komunikuarit tek banorët në Devoll. Gj. Karaiskaj pasi përshkruan ndërtimin e Gradinave të Shyecit e të Ventrokut, deklaron që ato përbëjnë të vetmit fortifikime të këtij lloji në Shqipëri.

1.8 KALAJA E BILISHTIT

Kalaja e Bilishtit gjendet në qytetin e Bilishtit ndodhet në majë të kodrës në anën verilindore të qytetit dhe ka formën e një kupole me pjerresi të njëjtë nga të gjitha anët e saj. Ajo është ndërtuar në vend strategjike prej të cilit kontrollohet e gjithë fusha e Devollit deri në qafën e Zvezdës. Qëllimi i ndërtimit të fortifikimit të kalasë ishte kryesisht me karakter mbrojtës ushtarak sepse zona brenda saj ishte qendër banimi e prodhimi. Kalaja është rrethuar me mur me trashësi rreth 3-3.5 m. që është ndërtuar me gurë të vënë një mbi një, pa lidhje, pra, thatë; sipërfaqja ka dimensionet 120 m. X 60 m., për të hyrë në kala ka vetëm një portë dhe koha e përdorimit të saj ishte shumë e shkurtër.

Kalaja datohet si ndërtim i periudhës së Hekurit të Hershëm, natyrisht, banorët që jetonin Brenda saj ishin më të hershëm. Studimet tregojnë që koha e përdorimit të kalasë ishte shumë e shkurtër. Ky fat argumentohet nga që mbetjet e qeramikës që janë zbuluar këtu dëshmojnë



²⁸N. Ceka "Udhëtim..., vepër e cituar, fq. 10-11.

se ajo është banuar vetëm në gjysmën e parë të periudhës së hekur, gjetje arkeologjike që t'i përkasin periudhave të mëvonshme nuk ka. Studiuesit pohojnë që qeramika e zbuluar në territorin e Kalasë së Bilishtit është e njëjtë me atë që është gjetur në vendbanimin prehistorik të Trenit. Kjo vërteton lidhjet e marrëdhëniet që kishin në prahistori banorët e këtyre vendbanimeve të Dasaretisë të cilët dihen që janë paraardhës të devollinjëve të sotëm.

1.9 KALAJA E MOGUT


Kalaja e Mogut gjendet në kodrën që është vazhdim i asaj ndodhet Kalaja e Trajanit. Kjo e fundit lidhet me të parën nëpërmjet një qafe që shërben si udhë kalimi. Aktualisht, këtu ruhet si gjetje arkeologjike, një mur rreth 50 m i gjatë që në ditët tona njihet si Kalaja e Mogut. Ky ndërtim i takon periudhës protourbane dhe ka shërbyer si pritë paraprahe mbrojtjeje për çdo rast rreziku që kërcënonte vendbanimin në Kalaja e Trajanit

1.10 PIKTURA SHKËMBORE E SPILES

Shkëmbi pak më sipër e në të majtë të rrugës për në Shyec, është vendi ku pak metra mbi tokë ndodhet piktura që nga vendasit njihet piktura e Spiljes. Në të paraqitet një moment gjuetie ku katër kalorës me qentë e tyre ndjekin gjahun, drerët. Figurat janë paraqitur në siluetë, të bëra me ngjyrë të bardhë dhe si kohë datohen të fillimit të epokës së hekurit. Studiuesit pohojnë që ajo është ndër të paktat piktura shkëmbore në vendin tonë si dhe duke u mbështetur në teknikën e përdorur, pohojnë që realizimi i përket një kohe të vetme. Piktori i lashtë i vizatimit nëpërmjet pikturës prezanton jetën e përditshme të banorëve të zonës. Vendosja e kompozimi i figurave sipas pjerrësisë që formon faqja e shkëmbit, është element karakteristik i artit të periudhës prehistorike, kohë që datohet piktura shkëmbore e Spiljes.

1.11 KALAJA E MENKULASIT

Kalaja e Menkulasit ndërtuar në juglindje të fshatit me të njëjtin emër, kufi me fshatin Ponçarë në pjesën e sipërme të lumit Devoll. Rrethimi i saj është fortifikim i cili i përket periudhës midis shek. IV-VI e. sonë, dhe është realizuar sipas traditës ilire, d.m.th., me gurë të vendosur njëri pas tjetrit, pa mjete lidhëse. Theksojmë që në rastin e ndërtimit të kalasë së Menkulasit kemi të bëjmë me risinë e kohës kur nisën të ndërtohen e fortifikohesh kala strategjike gjatë luginave të lumenjëve, zakonisht, pranë rrugëve që shërbenin për transport mallrash tregtare e trupash ushtarake. Studiuesi Gj. Karaiskaj në pasi shkruan për vendet, qëllimet e rolin e ndërtimit të kalave, kështjellave e fortifikimeve në Devollin e lashtë, shpreh konkluzionin: "Në pellgun e Korçës nga mënyra e vendosjes së fortifikimeve kuptohet që ato kishin për qëllim të siguronin një mbrojtje për gjithë këtë zonë dhe nga ana tjetër të kontrollonin kalimin gjatë luginës së Devollit... fortifikimet mbyllnin vendkalimet e mundëshme që lidhnin pellgun e Korçës dhe të Devollit me krahinat për rreth duke u vendosur në grykat e lumenjve ose në qafat. Rruga natyrore që kalonte gjatë luginës së Devollit kontrollohej nga kalaja e Menkulasit." Në përfundim, shtrojmë pyetjen: Cilat ishin arsyet që banorët Dasaretas, paraardhësit e devollinjëve të sotëm, të cilët pohohen që janë me origjinë prehistorike, prej Epokës së Neolitit e, në vijimësi, sidomos, në të Bronzit, të Hekurit, në të dy anët e kodrave përgjatë luginës së Devollit në një territori të vogël, rreth Grykës së Ujkut, skajit jugor të liqenit të Prespes, ndërtuan kaq shumë gradina, fortifikime e kala?



Disa prej shkaqeve historice pse ka ndodhur kështu janë:

- Pranë tyre ndaheshin territoret mes Ilirisë, konkretisht, Dasaretisë e Maqedonisë.
- Ndërtimet kishin karakter mbrojtës dhe krijonin mundësi vrojtimi për rastet kur sulmoheshin, për rrjedhojë merrnin masa për të mbrojtur veten dhe pasurinë.

- c) Brenda objekteve ruanin prodhimet bujqësore, blegtorale, zejtarisë, peshkimit etj.
- d) Nxirrnin e shfrytëzonin për armë e vegla pune hekurin e vendburimit të Bitinckës.
- e) Vendbanimet e cituara ishin pranë rrugëve që i lidhnin me qendra urbane të zhvilluara.

Në territorin Tren-Ventrok-Shyec-Zagradec evidentuam disa ndërtime fortifikimesh e mure mbrojtës kalash të cilët janë ndërtuar me mure guri, relativisht, të mëdhej në formë katërkëndëshë, vendosur të papunuar, njëri mbi tjetrin, të palidhur me mjete lidhëse, llaç, çimento etj. Të tillë janë dhe fortifikimt në territorin që përfshinte më gjerë Dasaretia, si në Selcë të Poshtme (ndoshta të Pelioni), kalave në Kakaç, Bellovodë, Gradishtë, Gjonomadhi, fortifikimi në Zvezdë, kalave në Ventrok, Bilisht, Menkulas etj. Ky lloj ndërtimi, mur me gurë të mëdhenj vendosur njëri mbi tjetrin pa mjete lidhës, quhet ndërtim ciklopik, modeli i parë është Akropoli i Athinës, por ndërtime të tillë gjen në Itali, Spanjë, Francën jugore, arqipelagun e Egjeut, pellgun e Mesdheut, Azi të Vogël, Mesopotaami etj. Prania e kësaj teknike ndërtimi bind për vazhdimësinë e jetës në fiset ilirë të Dasaretisë e të Eordesë. Ky fakt ka vlerë sepse argumenton që në këto troje etnikë ilirë dhe ku jetonte popullsia, pikërisht këtu ku janë rrënjët historike të devollinjëve të sotëm, është ruajtur e përcjellë përvoja e përdorimit të gurit të pagdhendur në ndërtimin e mureve. Ne pohojmë që toponimet Shpella e Trenit, Gradina e Shyecit, Kalaja e Ventrokut, Kalaja e Trajanit, Kalaja e Mogut, Kalaja e Bilishtit, Piktita shkëmbore e Spiljesdhe Kalaja e Menkulasit, janë terama të njohur në Onomastikën shqiptare. Duke u mbështetur në sqarimet përkatëse, sidomos, në datimin e ndërtimit të tyre, pohojmë që janë përjetësuar si simbole me vlerë emërtimi në Devoll e më gjerë, sepse argumentojnë se vendet që emërtojnë janë me origjinë prehistorike.

1.12 TOPONIMIA E DEVOLLIT

Njohja e studimi i toponimisë së njësisë etnografike të krahinës së Devollit është vlerë sepse në përmbajtjen e saj përcillen gjurmë epokash të hershme të vendbanimeve, historisë e gjeografisë iliro-albano-shqiptare. Evidentimi i toponimisë së Devollit, në mënyrë jo shteruese, është dokument i pazvendësueshëm njohjeje. Fati i rrugës nëpër të cilën ka ecur popullsia e fshatrave të Devollit të sotëm dhe i pjesës, sot në Greqi, ia shtojnë vlerat evidentimit të pasurisë etnokulurore të toponimisë së krahinës. Religjioni i Devollit përfundoi formimin si njësi etnografike krahinore, në gjirin e kombësisë shqiptare në shek. XV dhe një tregues i ngultësisë e i zhvillimit të këtyre njësive etnografike janë fshatrat që hyjnë në përbërjen e tyre. Krahinat, si njësi etnografike të dallueshme qartë mes tyre, kanë toponiminë për çdo vendbanim të tyre e cila është pjesë e pashkruar e historisë së saj.

Toponimet, shkruan S. Konda, janë si zbulimet arkeologjike që dalin në shesh me anën e gërmimeve të cilat nxjerrin në dritë jetën e popujve parahistorikë, kurse toponimet tregojnë emrin dhe gjuhën që flisnin, pra, kombësinë e tyre. Kur kombinohen këto të dyja, formojnë histori të pagabuar për popujt, emri i të cilëve do të mbetet i panjohur përgjithnjë. Pra, toponimet janë gjurmët e popullit që ka banuar aty ku gjennden ata." fq. 40 Gjatë punës sonë hulumtuese studimore ky mësim i vyer i Prof. Kondës është motivues për të argumentuar synimin e punës sonë: Toponimia e Devollit është autoktone me origjinë prehistorike e shprehur, kryesisht, me fjalë të brumit të gjuhës shqipe.

1.13 DISA VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË TOPONIMISË

Toponimet janë objekt studimi i onomastikës si dhe një pjesë e rëndësishme e veçorive linguistike të një krahine. Në thelb ata janë pjesë e zhvillimeve të shkuara e të sotme që tregojnë realitetin historik, gjeografik, gjuhësor e social të periudhave tëshkuara e të së sotmes për fshatra të caktuar e, në tërësi, për njësitë etnografike ku përfshihen. Toponomet grupohen në oikonime, emrat e vendeve të banuara, ku bëjnë pjesë dhe etnonimet, hidronimet, emërtimet e ujërave, si lumenjtë, liqenet, burimet, përrenjtë etj. dhe oronimet, emrat e maleve, kodrave, fushave, tokave, fushave.

Njohja dhe studimi i emrave gjeografik ka rëndësi sepse, siç thekson Çimohovski, "Emrat gjeografikë, në qoftë se lokalizohen me përpikmëri, marrin një rëndësi shumë më të madhe se emrat e personave, kuptohet vetvetiu se tiparet topografike mund të shpjegojnë në njëfarë mënyre shpjegimet e këtyre toponimeve".²⁹

Njësia etnografike Devollit, përfshin në territorin e saj historik të saj afro 80 fshatra nga të cilët 45 janë pjesë e Bashkisë Devoll, me qendër Bilishtin dhe pjesa tjetër është në territorin grek. Ne kemi hulumtuar në 39 fshatra=87%, dhe kemi mbledhur 5132 toponime. Gjithashtu, jemi konsultuar me 637 toponimet ka mbledhur F. Rrapaj në 11 fshatra të krahinës, sot në Greqi. Arsyetimin tonë e kemi mbështetur në studimin e 5779 toponimeve të mbledhur në 50 fshatra të njësive etnografike të krahinës së Devollit.

Në fshatrat e Devollit gjithçka që ndodhet mbi e nën tokë, ka patur e ka një emër të cilën e kemi klasifikuar duke marrë për bazë: a. Vjetërsinë e përmbajtjes; b. Lashtësinë e fjalës, d.m.th., ato që janë pohuar si fjalë të trashëguara nga ilirishtja prehistorike, pjesë e familjes së gjuhëve indoevropiane; c. Origjinën, fjalë të burimit sllav, grek e bizantin; d. Pasurinë tjetër të madhe të emërtimeve.

1.14 MAKROTOPONIME GJEOGRAFIKE ME ORIGJINË PREHISTORIKE

Toponimi "Devoll" është një ndër pohimet më të rëndësishë të albanologjisë shqiptare e disa studiuesve të huaj, të cilët midis fjalëve pakta me origjinë nga ilirishtja e vjetër në gjuhën e sotme shqipe, rendisin dhe emrin "Devoll". Ja disa pohime:

*Ptolemeu, gjeograf, shek. II e. sonë, është i pari që përmend termin "Diobolis", fjalë që është më afër formës "Devoll".

*Dh. Pilika rendit 156 fjalë pellazgo-ilire që etimologjinë u shpjegon me përputhjen mes onomastikës pellazgo-ilire me shqipen sotme. Ai shkruan: "... Dasi, Dasareti, Dazi, Dazima (dash), Devolia=Devolli."

*P. Ikonomi, thotë se Devolli e ka marrë emrin nga Deolum, Deoli-Deolli. Emri vjen nga fjala latine Deus (Divus)-Perëndi (i shenjtë), d.m.th. deo-lum a deo-lumi, deolum-deoli-Deolli. Ky lum në kohë të vjetra ishte i pa bashkuar me Osumin e kishte një rrugë tjetër që sot ka emrin "Dell-i", atëherë quhej Eordhaik."

*Sh. Demiri, akademik, duke u mbështetur në ligjësitë e zhvillimit të gjuhëve, argumenton që nëse do kishim një popullsi që mund të ketë folur greqisht, grupi /li/ vështirë të ketë dhënë /l/. Po t'i përmbaheshim tezës se në këto territore përdorej latinishtja, grupi /li/ s'mund të ketë dhënë /l/. Në gjuhët sllave, ky grup nuk mund të gjendet para zanoreve të përparme /i, /e, /j/. Sipas këtij arsyeimi, emërtimi Devoll nuk mund të jetë me ndërmjetësi sllave.

Gjatë shekullit të kaluar e në vijim, studiues të huaj, si I. Ivanov, Mlladevov, Vojkov etj. e ndonjë shqiptar, prejardhjen e emrit Devoll e shpjegojnë si fjalë të burimit sllav. Ata pohojnë që fjala ka dy rrokje, e para "de" =ajs o ka dhe rrokja e dytë, "voll" = ka dhe të dyja formojnë fjalën "ajs (ec) o ka." E. Cabej, albanologu ynë më i madh ka deklaruar që emri "Devoll" është nga të paktat fjalë të burimit prehistoric. Këtë përfundim shkencor e pohon Sh. Demiraj kur shkruan: "Disa gjuhëtarë (Weigand-i, Georgievi etj.) mendojnë se toponimet e vendeve të trashëguara nga koha e lashtë, si Tomor, Shkumbin, Durrës, Vlorë, Devoll, Shkodër etj. nuk kanë pasur zhvillime fonetike në përputhje me ligjësitë e evolucionit fonetik të gjuhës shqipe...Por Cabej dhe Cimochowski mendojnë krejt ndryshe. Sipas këtyre, ata (d.m.th., emrat e cituar-H.K.) kanë pasur zhvillime fonetike në përputhje me ligjësitë e evolucionit të sistemit fonetik të gjuhës shqipe dhe, si rrjedhim, dëshmojnë për autoktoninë e hershme të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme...këta emra bashkë me emrat e njërëzve e të perëndive përbëjnë sot për sot lëndën kryesore, që është ruajtur qysh nga kohët e lashta prej trevave të ilirëve të jugut, sot të banuara nga popullsi shqiptare."

²⁹Kuvendi..., vepër e cituar, fq. 254.

1.15 MAKROTOPONIME QË SHPREHEN ME FJALË TË ILIRISHTES

Gjuha shqipe në fjalorin e saj aktiv ka një fond të pasur fjalësh që janë me origjinë prej ilirishtes, pjesë e tringut të gjuhëve indoevropiane. Prej fjalëve të vjetra të brumit të ilirishtes si gjuhë indoevropiane, shqipja ka trashëguar një sasi të mjaftueshme. Shumë prej këtyre fjalëve me origjinë prehistorike në territorin prehistorik ku shtrihet njësia etnografike krohinore e Devollit, kryen funksionin e termave makrotoponimeve prej të cilëve, ndër shekuj, lindën e jetojnë qindra mikrotoponime.

1.16 MAKROTOPONIME QË LIDHEN ME VENDBANIME

Devoll, E. Cabej, Sh. Demiraj, Dh. Pilika, P. Konomi etj. pohojnë se është fjalë qëgjatë periudhave të zhvillimitë evolucionit gjuhësor që ka kaluar shqipja, përfundoi në formën që ka sot.

Dash pohojnë M. Domi, Sh. Demiraj e Dh. Pilika, është rrënjëe fjalës Dasareti, emër krahine.

Dhi, është fjalë prehistorike, sipas Cabejt e Dh. Pilikës, dhe rrënja e fjalës Eorde, emër krahine. Në zonë del dhe me format, si Stani Dhive, Prapackë,

Dhe-u- Dheri Bardhë, Braçanj, e Trestenik, Dheri Zi, Cetë, Gropat e Dherit, Shyec.

Gur - Sh. Demiraj, S. Konda e M. Aref, e deklarojnë fjalë të ilirishtes. Në toponimi ndeshet në format, si Guri, Cetë e Gërleñj, Guri i Capit, Bradvicë, Guri Prerë, Shyec e Shag, Gur i Rrahut, Dardhë, Guri Shpuar, Grapsh e Kapshticë, Guri me Kokë, Braçanj, Gur i Yzos, Vinan, Guri Gjatë, Maçurisht e Hoçisht, Guri Shqiponjës, Cangonj Revan, e Sinicë, Guriçkat, Menkulas, Kurilë, Tërstikë etj.

Mali-i, është fjalë që M. Domi, Sh. Demiraj, S. Konda e M. Aref epohojnë të ruajtur prej ilirishtes. Toponimet shfaqen në format, Mali i Kuq, Arrëz, Mali Ivanit, Progër, Pripor, Vërnik, Mali Hijës, Mali i Brinjës, Mali i Mashores, Mali i Grëndës, Mali i Stranës, Mali de Bleta, Mali de Gropa etj.

Pellg është fjalë e argumentuar prej ilirishtes nga Sh. Demiraj e M. Aref. Prej saj lindenformat, si Pellgoza, Vranisht, Pellgu Madh, Dobranj, Llomet, Menkulas, Llomet e Danickës, Progër etj.

Arë-a, makrotoponim nga lindën mikrotoponimet, si Ara, Vinan, Arushka, Arrza (fshat), Arrzë, Arrzë (arë), Koshnicë, Ara Gjokbardhit, Gërleñj, Ara e Ariut, Ponçarë, Ara me Kthis, Kapshticë, Ara Laraskës, Dobrolisht, Ara Naqes, Trestenik, Ara Argjirëve, Vërnik, Ara Cicanit, Sinicë, Ara Shelgut, Vishocicë, Ara Myslymit, Dobranj, Arat e Panos, Qytezë, Arat e Bardha, Vranisht etj.

Korije-a- është në Devoll një nga makrotoponimet më tëpasur me mikrotoponime për shkak se dikur në territorin e tij kodrinoro-malor kishte pyje të vegjël të veshur me drurë apo shkurre. Toponime me rrënjë këtë fjalë janë si p.sh. Korijs, Sinicë e Vina, Korijs, Vërnik, Vërlen Zelengrad, Korijs e Madhe, Braçanj, Korijs Shaqirit, Shag, Korijs e Rrahut, Dardhë, Korijs Fshatit, Dobranj, Korijs Shën Pjetrit, Grapsh, Korijs Priftit, Tërstikë, Korijs Florës, Ziçisht, Korijs Orvalinës, Poloskë.

Bregu-u është toponim që haset në fjalë të formës si p.sh. Bregu, Ziçisht, Menkulas, Maçurisht, Brigjet, Sul, Bregu Shytikës, Zelengrad, Bregu Pellagjisë, Hoçisht, Bregu i Madh, Pilur, Bregu Vidhit, Revan, Bregu Plakës, Trestenik, Bregu Shegunit, Shyec, Bregu Qeramicës, Kapshticë.

Shur-i, rrë-a, është fjalë shqipe prej ilirishtes e pohuar nga S. Konda. Disa forma mikrotoponimesh janësi Shuri, Progër, Verlen, Fushëzë e Pilur, Shuri Bardhë, Dobrolisht, Shuriga, Progër e Qytezë.

Lëmë-i- Lëminjtë, Bitinckë, Shyec e Trestenik, Lëmkat, Vidëhovë e Miras, Lëmi i Aliut, Poloskë, Lëmi Cetit, Grapsh, Lëmi Mires, Fushëz, Lëmi Shites, Vinan, Lëmi Rrapos, Sul etj.;

Zall-i- Zalli, Menkulas, Zallkat, Kuç, Zallishta, Maçurisht.

Varr-i- Varret, Menkulas, Varri Mirë, Vidëhovë, Varret e Xhamisë, Zelengrad, Varri Kapedanit, Cetë, Varret e mbëdha, Shag, Var i Turkut, Dardhë, Varret e Gorës, Kapshticë.

Cukë-a- Cukat, Sul, Cuka Lartë, Zelengrad, Cukat nga Brinjët, Miras, Cuka e Mullitit, Shyec.

1.17 MAKROTOPONIME QË LIDHEN ME EMRA KAFSHËSH

Ulk-u-ujku- sipas argumentimit që bëjnë E. Cabej, Sh. Demiraj e M. Arefi, është fjalë prej ilirishtes. Në zonë del me format, si Gryka e Ujkut, Përroi i Ujkut, Tren, Bregu i Ujkut, Dobrolisht.

Ari-u- emër që në zone del me format, si: Guri i Ariut, Eçmenik, Vëra e Arift, Sinicë, Vëra Ariut, Kapshticë e Dobrolisht, Stena e Ariut, Pilur, Plloça e Ariut, Bickë

Dhëlpër është mikrotoponim që më shumë është përdorur në numrin shumë, si: Dhëlpër, Shyec, Vrima e Dhëlpërës, Vishocicë, Sinicë, Vërat e Dhëlpërës, Vidëhovë.

1.18 MIKROTOPONIME QË LIDHEN ME DRU FRUTORË

Dardhë është fjalë e ilirishtes së vjetër dhe studiuesit e konkretizojnë me termin Dardani. Mikrotoponimia e kësaj fjale në Devoll paraqitet, relativisht, e pasur. Ky reletet gjuhësor spjegohet sepse, siç pohon Gj. Shkurtajt, gjuhëtar i njohur, "...për rrethanën e ditur se fitonimi dardhë del si një fjalë e moçme iliro-ballkanike." Gjithashtu, ka ndikuar dhe origjina prehistorike e banorëve të cilët e përdornin si fjalë pasi më parë e njihnin atë si dru frutor. Makrotoponimi dardhë është në Devoll ndër më të pasurit me mikrotoponim edhe pse fshatrave të Devollit kjo pemë frutore është e përhapur gjithandej. Format e toponimit të saj dalin në format, si Dardhë fshat, Dardhat e Gjata, Shyec, Ara e Dardhave, Rakickë, Dardha e Shpatave, Zagar, Dardha Kryq, Qytezë, Dardha e Mitros, Dobrolisht, Mali i Dardhushkës, Bitinckë, Dardha e Osmanit, Zagradec.

Goricë-a, quhet dardha e egërqë rritet në mal e kodër. Fjalët mikrotoponime emërtimin e kanë nga fjala sllave, gora=mal, pyll si p.sh.: Gorica, Maçurisht, Vishocicë, Goricat, Trstenik, Gorica, e Vogël, e Mesme, e Madhe, Tren, Gorickat, Kurilë, Gorica e Lekos, Verlen, Gorrica de Varret Progër. Thanë-a- Thana, Ziçisht, Thana e xha Bidos, Trestenik, Bithanë, Vidëhovë, Hardhi-a-vreshti. Përshkak të përbërjes së tokës e të kushteve të favorshme klimatike, gjendet në shumicën e fshatrave të Devollit. Mikrotoponimia e pasur në numur e shprehur në numurin shumë dëshmon origjinën e lashtë të këtyre emërtimeve që dalin në format, si Vreshti, Tërstikë, Vreshtka, Eçmenik, Vreshët, Miras, Vreshtët e Vjetra, Menkulas e Kapshticë, Kodrat e Vreshëve, Hoçisht, Dënë Vreshtat, Trestenik, Vreshta e Mestanit Vidohovë, Burimi i Vreshtkave, Eçmenik etj. Në zonë ndeshim dhe emërtime, *variante me përmbajtje* sllave, si llozen/kë, si p.sh. Llazinë-Llozinat, Miras, Llozjet, Vërnik, LLoziet, Çetë etj.

Lajthi-a është mikrotoponim që ndeshet në format si p.sh., Lajthia, Dobranj e Sinicë, Lajthitë, Verlen, Tërstikë, Gërleñj, Lajthishta, Ponçarë Lajthia e Çipanit, Çipan, Lajthi e Sheros, Vidëhovë, Lajtha Thekos, Cetë, Lajthisë, Sinicë, etj. Hasen dhe variante me fjalën leskë të burimit sllav, si p.sh. Leska, Macurisht, Progër, Rakickë e Trestenik, Leska e Canes, Rakickë, Leskat, Zagradec etj.

1.19 MIKROTOPONIME QË LIDHEN ME DRU JO FRUTORË

Dushk-u, sipas E. Cabejt, është fjalë e burimit të vjetër të shqipes. Sot del me format, si: Dushku, Dardhë, Dushkadin, Grapsh, Dushku i Parë, i Dytë, Dardhë, Dushqe, Vranisht, Dushqet, Koshnicë e Shag, , Koriça e Dushkut, Pilur, Arat e Dushkut, Dardhë, etj.

Arrë=kaçkë toponim që del me formatsi: De Kaçka, Shyec, Bregu i Kaçkës, Trestenik, Kaçka e Vaitit, Menkulas, Kaçka e Borshit, Poloskë, Kaçka e Pastërmajit, Ziçisht, Kaçka e xha Feimit, Baban.

Lis-i toponim që del në format, si Lisi Shyt, Grapsh, Lisi i Bankës, Çetë, Liskat e Berberit, Koshnicë, Ara de Lisi, Miras, Qafa e Lisit, Shyec, Koriça e Kopaçit me Lis, Baban, Lisec, Dardhë etj.

Bush-i makrotoponim që del me format, si Çuka me Bush, Rakickë, Mali de Bushka, Bitinckë.

Shelg-u, toponim del në format, si Shelgu, Vranisht, Shelgishta, Shënkolas, Shelgu i Ibushit, Koshnicë), Shelgu i Alushit, Menkulas, Shelgjet e Lames, Ziçisht, Arat e Shelgjeve, Sinicë.

Bredhi, mikrotoponim që gjendet pak, del me format, si Bredhi, Menkulas e Zagar, Ngaj Bredhi, Ponçarë, Bredhi Bubës, Dobrolisht, Proi i Bredhave, Stropan, Bredhi i Bigllës, Dardhë.

Plep-i, toponimet që haste pak në Devoll, forma me të cilat del janë, si Plepi Bilishtit, Bilisht, Plepi i Cenos, Vranisht, Plepi Pepift, Shag, Plepi Braçanjit, Braçanj, Plepishta, Hoçisht.

Gështenjë është makrotoponim që ka pakmikrotoponime, del me format, si: Korijs e Gështenjave, Ponçarë, Gështenjat, Dobranj.

Qarr është toponim që në zonë del pak, si Qari, Menkulas, Qarret, Koshnicë.

Ah-u, haset në format, si Ahu, Fushëz, Ahu e Ahu Slimicës, Fushëzë, Ahu i Fushëzës, Gërleñj,

MIKROTOPONIME QE LIDHEN ME EMRA BIMESH

Kërp-i është fjalë me origjinë nga ilirishtja por duket se ka qënë bimë që është kultivuar pak në zonë prandaj ndeshen pak toponime si p.sh. Kërpishta e xha Bektashit, Rakickë.

Lëmpjetë-a është një bimë për të cilëgjejmë pak mikrotoponime të forms si p.sh. Lëndina e Lëmpjetave, Vranisht.

Fier-i është fjalë me të cilën janë formuar pak toponime të formës si Fjeri, Trstenik, Fjerishta, Gjyres, Hoçisht, Trstenik e Tren, Fjerishtet, Vishocicë, Burimi i Fjerit, Sul, Ngaj Fjerishta, Bradvicë etj.

1.20 MIKROTOPONIME QË LIDHEN ME EMRAT KROI, BURIMI DHE MBIEMRAT I BARDHË DHE I MADH

Makrotoponimet e këtij sythi janë fjalë të trashëguara nga ilirishtja. Zona e Devollit është e pasur me burime ujore, prandaj me fjalët makrotoponime burim, kua dhe përroi hasim dendur mikrotoponim.

Kroi. E. Cabej e Sh Demiraj pohojnë që është fjalë nga ilirishtja. Devolli është i pasur me burime ujorë prandaj del shpesh si toponim në format, si Kroi Gurit, Cetë, Kroi Mirë, Zelengrad, Kroi Yzbashit, Shag, Kroi Lajthisë, Tërstikë, Kroi Dardhës, Gërleñj, Kroi Kulluar, Dobrolisht, Kroi me Dhjamë, Koshnicë, Kroi Bereqetit, Revan, Kroi Bredhit, Zagar, Kroi Amatit, Sinicë.

Burim-i Burimi, Rakickë, Prapackë, Braçanj e Zagar, Burimi Pepellashit, Kapshticë, Cicat, Shyec, Burimi Gjokgjinit, Gerleñj, Burimi Curupujkës, Qytezë, Burimi Jankos, Cërçisht, Burimi Agos, Sinicë, Burimi Piut, Shag, Burimi Kërçurit, Pilur, Burimi Shqipes, Gërleñj, Burimi Arave, Bickë, Burimi Gaqit, Grapsh etj.

Përroi- Proi Sulit, Proi Thellë, Zagar, Proi Sathes, Zelengrad, Proi Vockë, Proi Kuqalit, Proi Meçkojatit, Proi Ploçkave, Proi Mijes, Proi Dendur, Proi Ollçovecëve, Përenjtë e Veckë etj.

I bardhë- del me format, si Dheri i Bardhë, Braçanj, Dheri Bardhë, Vinan, Dheu i Bardhë, Trestenik, Guri Bardhë, Zagradec e Zelengrad, Gurët e Bardhë, Vidëhovë, Ara të Bardha, Vranisht, Fusha e Bardhë dhe Bregu i Bardhë, Koshnicë, Çezma e Bardhë, Kurilë, Vari i Bardhë, Braçanj etj.

I madh. Toponimi del me format, si Guri i Madh, Vidohovë, Lisi i Madh, Prapackë, Ar'e Vogël dh Ar'e Madhe, Rakickë e Zelengrad, Gjambi Madh dhe Gjambi Vogël, Syec, Ar'e Madhe, Vishocicë, Fusha e Madhe, Bregu i Madh, Pilur, Shullëri i Madh, Miras, Pllaj' e Vogël, Zagar, Luadhi i Madh, Sinicë, Arat e Mëdha, Vidohovë, Eçmenik, Miras, Luadhet e Mëdhenj, Koshnicë, Varret e Mbëdha, Shag.

Popujt gjatë rrugëtimit shekullor për formimin e tyre, krahas gjuhës e vetëdijes historike e kulturore, krijojnë dhe një bashkësi emërtimeve gjeografikë, onomastikën përkatëse. Kjo pasuri "me gjithë ndryshimet e shumta që pëson në rrjedhën e histories, ruan edhe në kohët e reja elemente të lashtësisë dhe bëhet kështu tregues i lidhjeve të popullsisë së hershme me të sotmen, pra tregues i përkatësisë etnike të saj."³⁰ Kështu ka ngjarë dhe me lindjen, ruajtjen, pasurimin e përcjelljen nga njëri brez tek tjetri edhe me banorët e tojeve prehistoric të populluar nga banorë autoktonë të religjionit të Devollit. Në pasurinë prej mbi 5000 toponimesh të Devollit haset një numur toponimeshme origjinë sllave, më shumë, e më pak turke e greke. Për praninë e toponimeve sllave në fshatrat e Devollit, shumica e të cilave është bullgaro-maqedonase, do të

³⁰Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij", Tiranë, 1988, fq. 191.

ndalemi në dukuri të zhvillimeve historike e gjuhësore. Historiografia shqiptare pohon që "grupet e organizuara sllave që kishin arritur të depërtonin drejt luginave të Devollit e Osumit, nuk arritën të organizoheshin në bashkësi kompakte... Perandoria Bizantine shpërnguli popullsi të tëra sllave nga viset që ishin në rrezen e saj duke i çuar në Azinë e Vogël."³¹ K. Frashëri shkruan: "... në fakt, askush nuk ka ndeshur deri sot të tilla toponimi në trojet e sotme shqiptare para shek. IX."³²

Në Devoll periudha e lindjes së toponimeve sllave, sidomos, atyre bullgare, datohet koha kur bullgarët pushtuan e sunduan Maqedoninë Perëndimore e Shqipërinë e Jugut, shek. IX-XI. Bullgarë për qëllime administrimi shtetëror të viseve të pushtuara shqiptare të zonës Ohër, Devoll, Gllavenicë, krijuan rajonin e Kutmiçevicës, shek IX-XI funksionimi i së cilës krijoi marrëdhënie të reja administrative, ekonomike, gjuhësore, fetare, sociale etj.

Për kohën e formimit të gjuhës shqipe, Sh. Demiraj pohon se "elemente të huaja (huazimet nga greqishtja e mesme dhe e reja, latinishtja, sllavishtja e turqishtja H.K.) kanë depërtuar në gjuhën shqipe pas shek. VI, d.m.th., pas asaj periudhe kur u krye procesi i gjatë i kalimit të shkallëshkallshëm nga ilirishtja në shqipe"³³ Po ky gjuhëtar shprehet që "sllavizmat që kanë depërtuar në shqipe pas shek. IX janë më të shumtanë numur..."³⁴ M. Domi thotë se faza e parë e formimit të gjuhës shqipe përfshin periudhën prej lindjes së saj deri në kohën kur ajo filloi të bjerë në kontakt me gjuhët e tjera, shek. VI-VI." Gjithashtu shkruan: "Në fund të saj (fazës së parë-H.K.)shqipja e hershmeqë u krijua nga zhvillimi i mëtejshëm i ilirishtes, ishte formuar plotësisht me individualitetin e saj, me veçoritë e saj."³⁵

Studiuesit bullgarë, A. Selishçev, gjuhëtar, dhe B. Gjyzelev, historian, e pranojnë këtë fakt. Bile, bile, ky i fundit shkruan: "Në kohën kur stërgjyshërit e shqiptarëve morën kontakt me sllavët, në fund të shek. VI, gjuha e tyre (e ilirëve-H.K.) ishte e formuar"³⁶Për praninë e një numuri, relativisht të madh toponimesh në Devoll, ashtu si në kudo në Shqipëri, akademiku Sh. Demiraj shkruan "Prania e një numri të madh toponimesh sllave në Shqipëri është e shpjegueshme po të mbahen parasysh dy rrethana: së pari të kihet parasysh se viset e banuara nga shqiptarë kanë qenë të pushtuara për një kohë të gjatë nga dy mbretëri sllave; Së dyti, është e ditur që pushtuesit përpiqen të zëvendësojnë toponimet e mëparshme me emërtime nga gjuha e tyre". Mënyrat, format gjuhësore që bullgarët përdorën për krijimin e toponimeve të reja në vendbanime prehistorike, rrënjës, të krahinës së Devollit, që, natyrisht, deri në shek. IX, nuk ishin pa emra, ishin disa.

- Dublimi i emrave të ilirishtes u bubluan me emrasllav, si kokë=gllavë=Kokëgllavë.
- Njënumur i konsiderueshëm toponimeshnë Devoll të shprehur me fjalë të brumit të ilirishtes u zëvendësuan me përkthime të tyre në sllavisht.

Disa forma të tilla të trashëguar nga ilirishtja si bijë e familjes së gjuhëve indoevropiane, i hasim në rastet, siburim=Izvor, Progër, Braçanj, Vinan, Sinicë, Vidëhovë; harshi=leskë, luginë=llëngë, shtufë=stërmok, fshat=sello, mal=gore të cilat i ndeshim në shumë fshatra por studiuesit pohojnë ato, të parat, janë fjalë shqipe. Viojmë me shembuj të tjerë, si llozje=hardhi, Tërstik; kalive=kasolle, Stropan, Koshnicë, Miras, ulicë=rrugë e ngushtë, Braçanj. Aludohet që sllavët emrin e qytetit Theopolis=qytet i zotit që ishte emri i një vendbanimi të hershm, e emërtuan me fjalë sllave=Bozhigrad, pra me të njëjtat fjalë po sllave. Po kështu ndodh dhe me toponimet Mal i

³¹Historia e popullit shqiptar-I", Tiranë, 2002, fq. 207.

³²Konferenca..., vepër e cituar, fq. 57.

³³Sh. Demiraj "Gjuha..., vepër e cituar, fq. 116.

³⁴Po aty, fq. 121.

³⁵Konferenca..., vepër e cituar, fq. 176.

³⁶Bojan Gjyzelev "Shqiptarët në Ballkanin Lindor", Tiranë, 2005, fq. 18

Mirë=Dobërgorë, Arrëz; Starollozja=hardhi që prodhon rrush të zi, Tërstikë; Trestenik=tre stena; toka e Koljes=Kolepadinë, Qytezë, kreu i fushës=Krenopolje, Shag.

c. U ndërtuan toponimetë shprehur me fjalë të përbëra ku njëra pjesë ishte fjalë shqip e tjetra sllave të formave, si Përoi i Vërsulkut është toponim tipik i kësaj dukurie sepse ku pjesa e dytë i tij, Vërsulk, përbëhet nga vërs-fjalë sllave dhe ujk, një ndër emrat më të lashtë të ilirishtes, si Përroi i Lajthisë=Përroi i Leskës, epara shqip dhe e dyta sllave, Afshinakroi=afshina, fjalë e huaj, ndërsa kroi fjalë shqipe, Gërle; Zvori Demozykos=e para sllave, e dyta emër i përbërë shqip, Bello çezmë=bello bukur e çezmë shqip, Kapshticë. Gjithashtu, vihet re dhe dukuria e bigëzimit si në rastin e toponimit rrënjë qytezë me fjalën rrënjë sllave gradinë ose Gradishtë por Qytezë-a është toponim fshati në Devollin e Sipërm, emër+prapashtesë zvogëluese, qytet i vogël, ndërsa varianti sllav gradinë, ka kaluar në rrënjë që tregon tokë arë me sipërfaqe të vogël, si në Ziçisht, Sul, Grapsh. Forma Gradishtë shfaqet si Gradishta e Shyecit, Shyec, ndërsanë Vërle Gradishtë si fjalë që emërton vendin ku dikur u zbuluan mbetje, gërmadha muresh.

d. Emrat e dikurshëm, të vjetrit, u zëvendësuan me emra të rinj me përmbajtje të gjuhës së sllavëve të jugut, si Bozhigrad, Zagradec, Braçanj, Koshnicë, Dobranj, Stropan, Poloskë, Bradvicë. Jo vetëm kaq, sepse në Devoll, sipas hulumtimeve, rezulton që ishin dhe disa fshatra të tjerë të tjerë mbanin emra sllë por që për shkaqe të ndryshme u zhdukën. Të tillë emërtime përmendim, si Sellcë, pranë Bilishtit, Cangë, banorët e së cilës zbritën më poshtë e formuan Cangonjin, Nikolla, pranë Pilurit, Branjar, sipër Shënkollasit, zbriti për mungesë toke e formoi Shënkollasin, sot Fitore etj. Banorët e fshatrave të Devollit, rrjedhojë e punimeve qilizëm që u kryen për shumë vite, zbuluan në disa vende themele ndërtime, monedha, mbetje qeramike, qypa të mëdhenj (pitose), sende metalike, stoli të llojeve të ndryshme etj. Ata mendojnë që në këto vende, dikur, ka patur vendbanime, sot të zhdukur. Rastet më domethënëse janë, si Pavliqi, në Progër, Polihori, pranë Nikolicës, Ostriga, pranë Menkulasit, Okserdeni, pranë Ziçishtit, Ulicat, në Vishocicë, Jucka, në Kuç, Kapandriqi, pranë Pilurit etj. Gjithashtu, në Devoll janë dhe disa toponime fshatrash të emërtuar me fjalë të burimit sllav që u zhdukëngjatë shek. XVII-XVIII për shkak se banorët e tyre të krishterë nuk pranuan të konvertoheshin në myslimanë. Fshatra të tillë ishin, si Llabanica, pranë Trestenikut, Selishta, pranë Sinicës, Novoleni, pranë Cetës, Shmihilli (Shën Mëhilli-H.K.), pranë Vidëhovës, Brozdoveci, pranë Dardhës.

1.21 TOPONIME ME BURIM NGA TURQISHTJA E GREQISHTJA

Mikrotoponime me origjinë greke në Devoll hasen shumë pak dhe paraqiten në format, si: Rakonidhje, Llambanidhe, Kalimere, Qeramithana etj. Gjithashtu, i pakët është numuri i toponimeve me burim turk për arsye të rezistencës së devollinjëve ndaj presionit të tyre. Pushtimi turk ndikimoi në ngulitjen e një numri të kufizuar toponimesh për shkak të qëndresës së popullsisë së devollinjëve. Ato pak toponime që janë gjenden në format, si beu, tabori, qilari, saraji, meraja, meraja, xhamia, hajmalia, vakëfi, teqja, sallatashi etj.

1.22 TOPONIME ME NDËRTIME ARKAIKE, TRDICIONALE, TË TË FOLURIT NË DEVOLL

Devollit është njësi etnografike e një krahine të caktuar. Kjo dukuri ndodhi sepse, ndër të tjera, devollinjtë në të folurine tyre aktiv, krahasuar me banorët e simotrave të tyre, përdornin fjalë, parafratë, prapashtesa zvogëluese, ndërtime të veçanta fonetike shoqëruar me forma arkaike, tradicionale gjuhësore. Në pasurinë mikrotoponike të zonës hasen plot ndërtime të tilla veçori gjuhësore arkaike, si Bikoria e Dënë vreshtë, Vidohovë, Batanë Lumit, Bilisht, Bigur, Sinicë, De Kaçka, Shyec, Ngaj Lëmi si dhe të formave, si Ar'e Asllankës, Dhëf i Zi, Cetë, Dheri Bardhë, Braçanj, Mulliri Beft, Trestenik.

Në zonë ndeshen dhe toponime që tregojnë pronësi, si Mançevicat, Bitinckë, Martinica, Vërnik, Kodra Simovicës, Ziçisht, Kolovica, Koshnicë, Muçovicat, Shyec, lumka e Xhaferit, Koshnicë,

Cezma e Goçe Arifit, Koshnicë si dhe me emra të përngjitur, formuar ndër shekuj, si Gjinkova, Vidëhovë, Krohasani, Qytezë, Granopolet, Revan, Aliosteni, Kapshticë, Kristopani, Grapsh, Gollobrati, Vranisht. Gjithashtu, hasen toponime që janë formuar me prapashtesat zvogëluese, si -ka, Sheshka e Peros, Qytezë, Tiganka, Ziçisht, Misurka, Sinicë; me prapashtesë zvogëluese -kë si: Lumkat, Koshnicë, Krasatkat, Menkulas, Evgjitkat, Vidohovë, Shytka, Cetë, Koroveshkë, Progër, Miras, Shënkollarka, Fitore, Liqenkat, Dardhë, Llënkat, Bitinckë, Bucelkë, Braçanj, Tigankat, Menkulas, Tri Misurkat, Vranisht; me prapashtesën -zë, si Balzë, Cetë, Humbëzë, Grapsh, Qershizë, Fushëzë, Dardhë, Qytezë, Gurzë, Koshnicë, Dorzat, Sul; Me prapashtesë zvogëluese -çkëj, si: Avliçkat, Menkulas, Guriçkat, Shyec, Qershicëkat, Dobranj.

F. M. Rrapaj shkakun pse në Devoll, si kudo në Shqipëri, ndeshen toponime të huaja, e argumenton duke thenë: "Ato kanë mbetur aty bash si ato këmbët e karkalecëve kur ata marrin vrull e kapërcejnë nga njeri vend në tjetrin në kërkim të ushqimit, duke lënë gjymtyrët e tyre udhëve të botës"

Devollinjtë në çdo fshat kanë emërtuar gjithçka; kështu ka ngjarë me cdo shkëmb, gjurmë, vrimë e shpellë, çdo mal e kodër, çdo lumë, krua, burim e pus, çdo shpellë e gur, çdo pyll e korie, çdo qafë e grykë, çdo livadh e kullotë, çdo udhë e muli, çdo arë, dru e pronë të dikujt, çdo territor me lis, ah, dushk, vidh, bredh, goricë, drizë, dëllinjë etj. si dhe për arat e mbjella me dardha, mollë, kumbulla, fiq, kaçka (arra), qersh, lajthi etj., çdo shesh e lëmë, çdo vend shenjtë, objekt kulti, çdo lloj varri apo varrezash etj.

Toponimet në Devoll janë realizuar në unitet të plot me mbarë onomastikën shqiptare. Përmbajtja e tyre tregon që emërtimet me karakter historik janë në pajtim me zhvillimin e ngjarjeve që kanë ndodhur në në vendin tonë, sidomos, në krahinën e Devollit. Emërtimet që hasim në çdo fshat kanë lidhje logjike mes tyre si dhe fjalët me të cilat shprehen, shumica, janë prej brumit të ilirishtes. Në tërësinë e toponimeve të zonës pranohet që hasen dhe huzime e prani toponimesh me burim nga gjuhë të huaja. Edhe përse i takon formave fonetike e morfologjike që fjalëve, ka vijueshmëri sepse shumica, janë shprehur me fjalë shqip prej brumit të ilirishtes duke iu përshtatur periudhave historike nëpër të cilat ka kaluar evolucioni i zhvillimit të shqipes, pjesë e familjes së gjuhëve indoevropiane. Pasuria e toponimisë në Devollit, krahas argumenteve të shkencave të gjuhës, historisë, gjeografisë, etnokulturës etj, pohon që Devolli, si territor kufitar i Shqipërisë, ka qënë dhe mbetet pjesë e viseve shqiptare dhe pasuria e saj është vlerë e onomastikës së kombit tonë.

2. PËRFUNDIME

- Njohja e studimi i toponimisë së njësishë etnografike të krahinës së Devollit është vlerë sepse në përmbajtjen e saj përcillen gjurmë epokash të hershme të vendbanimeve, historisë e gjeografisë iliro-albano-shqiptare.
- Toponimet në Devoll janë realizuar në unitet të plot me mbarë onomastikën shqiptare. Përmbajtja e tyre tregon që emërtimet me karakter historik janë në pajtim me zhvillimin e ngjarjeve që kanë ndodhur në në vendin tonë, sidomos, në krahinën e Devollit. Emërtimet që hasim në çdo fshat kanë lidhje logjike mes tyre si dhe fjalët me të cilat shprehen, shumica, janë prej brumit të ilirishtes.

3. STUDIME MBËSHTETËSE

1. Aristidh Kola "Arvanitët, 2002.
2. Aleksandër Stipçeviq "ILIRET-historia, jeta, kultura, simbolet e kultit", Tiranë, 2002.
3. Arsim Spahiu "Pellazgët dhe ilirët në Greqinë e vjetër", Tiranë, 2006.
4. Alfred Uçi "Mitologjia-Folklori-Letërsia", Tiranë, 1982

5. Bojan Gjyzelev "Shqiptarët në Ballkanin Lindor", Tiranë, 2005
6. Dhimitër Pilika "Pellazgët-origjina jonë e mohuar", Tiranë, 2005.
7. Edwin Jacquec "Shqiptarët", Tiranë, 1995.
8. Gjergj Karaiskaj "5000 vjet fortifikime në Shqipëri", Tiranë, 1981.
9. Historia e popullit shqiptar-I", Tiranë, 2002
10. Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Tiranë, 2002
11. Historia e popullit shqiptar-I", Tiranë, 2002
12. Kuvendi i studimeve ilire, Tiranë, 1974.
13. Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij", Tiranë, 1988.
14. L. Jankovski e A. Bakratcheff me listen e 804 4 emrave të qyteteve e fshatrave të Maqedonisë Perëndimore te clëve grekët u ndryshuan emret viteve 1926-1928.
15. Mathieu Aref "Mikenët-Pellazgët, Greqia ose zgjidhja e një enigme", Plejad, 2008
16. Mathieu Aref "Shqipëria-odiseja e pabesueshme e një populli parahelen", Plejad, 2007.
17. Myzafer Korkuti "Vendbanimi prehistorik i Trenit", Tiranë, Iliria I.
18. Neritan Ceka "ILIRET", Tiranë, 2001
19. Neritan Ceka "Udhëtim nëpër kështjellat ilire",
20. Skënder Aliu "Vlerat arkeologjike të Shqipërisë Jugore", Korçë, 2016, temë studimore.
21. Spiro Konda "Shqiptarët dhe problem pellazgjik", Tiranë, 1964.
22. Shaban Demiraj "Gjuha shqipe dhe historia e saj", Tiranë, 1988

